



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
Gjykata Kushtetuese / Ustavni Sud / Constitutional Court	
Njësia org Org. Jed Org. Unit	<u>DRLSA</u>
Nr Prot Br.Prot Prot.No	<u>814</u>
Nr. i faqeve Br. stranca No. pages	<u>7</u>
Data Datum Date	<u>08.05.2020</u>

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Pranuar / Prilijeno	
08 MAY 2020	
Në ora	çështja

Për: Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Nga: znj. Arbërie Nagavci, deputete e Lëvizja VETËVENDOSJE! – Nënkryetare e Kuvendit

CC: Arta Rama, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Lënda: Komente në lidhje me dekretin nr. 24/2020 të datës 30 prill 2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës

Datë: 08.05.2020

Bazuar në njoftimin e pranuar nga Gjykata Kushtetuese, me datë 30.05.2020, lidhur me regjistrimin e kërkesës KO 72/20 brenda afatit kohor të përcaktuar me Rregulloren e punës, nr. 01/2018, të GJK, konkretisht nenit 30 par. 6, parashtron komentet në lëndën KO 72/20 në mbështetje të Kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, si në vijim:

1. Më datë 25 mars 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë me shumicë votash të të gjithë deputetëve. Nga ai moment konsiderohet se qeveria bie. Sipas nenit 100, par 6 qeveria konsiderohet në dorëheqje. Ndërsa, sipas nenit 82 par 2, Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë. Pas këtij momentum kushtetues, Kushtetuta e Kosovës e aktivizon Presidentin e Kosovës, i cili në përputhje me rolin e tij kushtetues autorizohet që të shpërndajë Kuvendin e Republikës në përputhje me nenin 82.2, si dhe të caktojë datën e zgjedhjeve në bazë të kompetencës së Presidentit të përcaktuar me nenin 84 par 3.
2. Përkundër autorizimit kushtetues të Presidentit të Republikës së Kosovës për të shpërndarë Kuvendin, më 30 prill 2020, Presidenti, në kundërshtim të plotë me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 dhe nenin 84 par.14 lidhur me nenin 95 të Kushtetutës së Kosovës, përmes Dekretit Nr. 24/2020 i propozoi Kuvendit z. Avdullah Hotin për Kryeministër të Republikës së Kosovës. Z. Avdullah Hoti si kandidat për Kryeministër nuk u propozua nga partia apo koalicioni që ka fituar zgjedhjet, por nga Lidhja Demokratike e Kosovës si partia politike e cila në zgjedhjet e 6 tetorit të vitit 2019, ishte renditur si partia politike e dytë.
3. *Fillimisht duhet të theksojmë se në sistemin tonë kushtetues, arrijmë para së gjithash të vëmë në dukje se Presidenti i Republikës së Kosovës si pushtet neutral apo si përfaqësues i*

pushtetit asnjans, pra, që qëndron mbi palët, nuk hyn në ndarjen e pushteteve dhe nuk kryen asnjë funksion ekzekutiv në drejtimin politik të vendit. Koncepti i kreut të shtetit, prandaj, është më shumë një kategori kushtetuese formale që i takon presidentit të republikës, por që nuk nënkupton që Presidenti i Republikës vishet me karakteristika qeverisëse. I vënë në këtë kontekst, neni 83 ilustron pozitën formale të presidentit të republikës si kreu i shtetit dhe jo kompetencat/autoritetin e tij substancial. Pikërisht në këtë drejtim përcaktohet statusi i Presidentit të Republikës së Kosovës në kuptim të asaj se “*Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës*”. Nga kjo dispozitë kushtetuese kuptohet se Presidenti i Kosovës nuk lejohet t’i përfaqësojë interesat grupore ose politike partiake por i përfaqëson të gjithë së bashku, që i jep kuptim substancial përfaqësimit të unitetit të popullit të një shteti. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese konsideron se është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo interesa grupore ose interesat politike partiake, do t’i përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetarë i Republikës ka të drejtë të sigurohet për paanshmërinë, integritetin dhe pavarësinë e Presidentit të tyre. Mbi bazën e këtij statusi, Presidentit të Kosovës i janë përshkruar kompetenca kushtetuese për të materializuar rolin e tij si pushtet balancues apo “mediator institucionesh”, apo pushtet asnjans. Në kuptim të kësaj, për rastin konkret duhet të cekim se një ndër kompetencat e Presidentit të shtetit është se, ai është garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë kushtetutë. Në këtë kontekst, në kryerjen e funksionit të kreut të shtetit, sipas këtij neni, Presidenti i Republikës duhet përmbajtur këtyre katër parimeve: a) shprehjes së neutralitetit: në kryerjen e detyrës së tij si kreu i shtetit, presidenti i republikës nuk lejohet që të marrë veprime që lejojnë hapësirë për anim partiak, politik apo personal; b) kredibilitetit shtetëror: në kryerjen e këtij funksioni, presidenti i republikës përfaqëson shtetin dhe jo interesin e tij/saj personal apo partiak, prandaj publiku duhet të jetë i bindur arsyeshëm që veprimet në kuadër të këtij funksioni janë thjeshtë në përputhje me interesat e gjëra shtetërore, si në kuadrin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm; c) objektivitetit: në kryerjen e këtij funksioni, presidenti i republikës duhet të gjykoj objektivisht nga pritjet e publikut të gjerë sa i përket përfaqësimit të interesit shtetëror, dhe të veproj në mënyrë të tillë që pritjet e publikut për veprimet e kryera në kuadrin e këtij funksioni të mos lënë dyshim për anime personale të presidentit të republikës³⁵¹; dhe, d) kufizimi i këtij funksioni në aspekte formale: përcaktimi i vënë në nenin 83 për presidentin e republikës si kreu i shtetit duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, duke përjashtuar çdo hapësirë që kjo të nënkuptojë një autoritet substancial të qeverisjes në dobi të presidentit të republikës.¹

4. Duke pasur parasysh statusin e Presidentit dhe kompetencat e tij, Presidenti duhet të përmbushë autorizimet kushtetuese duke materializuar kompetencat e tij në përputhje me Kushtetutën. Kjo për më tepër, kur Presidenti i Republikës ushtron kompetenca politike sikurse kur bën zgjedhjen ndërmjet kandidatëve konkurrentë nga koalicionet e mundshme për t’u bërë Kryeministër. (shih K0103/14). Në këtë kuptim, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë në tërësi, Presidenti i Republikës së Kosovës, sipas nenit 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 është dashur që të dekretojë shpërndarjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe të caktojë datën e zgjedhjeve në bazë të nenit 84 par. 3. **Megjithëkëtë dhe në kuptim të kundërt, Presidenti i Republikës më 30 prill 2020, ka nxjerrë dekretin Nr. 24/2020 në kundërshtim të plotë me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 dhe nenin 84 par.14 lidhur me nenin 95 të Kushtetutës së Kosovës, duke**

¹ Prof. Dr. Enver Hasani / Prof. Dr. Ivan Čukalovi, Komentar, fq. 388.

dekretuar një kandidat të ri për kryeministër, i cili nuk është propozuar nga partia politike apo koalicioni që ka fituar zgjedhjet.

5. Duhet theksuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, parasheh shprehimisht vetëm një veprim kushtetues. Ky veprim përcaktohet me nenin 82 paragraf 2, i cili autorizon Presidentin e Republikës së Kosovës që të shpërndajë Kuvendin. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, jo vetëm se nuk parasheh shprehimisht as mundësinë dhe as procedurën e krijimit të një Qeverie të re pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, por nuk përmban asnjë dispozitë kushtetuese që do të mund të shërbente si ndërlidhje në mes të votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë, respektivisht nenit 100 paragraf 6 dhe nenit 95, zgjedhja e Qeverisë. E vetmja ndërlidhje që ekziston në Kushtetutë, si literale, si funksionale e logjike e nenit 100 paragraf 6 “Votimi i suksesshëm i mosbesimit” është me nenin 82 paragraf 2 “Shpërndarja e Kuvendit”, si dhe të nenit 82 paragraf 2 me nenin 84 paragraf 3 “Shpalljen e zgjedhjeve”. Për më tepër, në kontekst të ushtrimit të autorizimit për shpërndarjen e Kuvendit, Kushtetuta e Republikës nuk parasheh asnjë hap apo përgjegjësi aktive të Presidentit për të vlerësuar apo konsideruar paraprakisht vullnetin politik të subjekteve politike, siç është konsultimi me partitë politike apo grupet parlamentare për shpërndarjen ose jo të Kuvendit. Megjithatë, brenda logjikës së Presidentit për të marrë për bazë vullnetin e subjekteve politike për shpalljen ose jo të zgjedhjeve, dy subjektet politike që përbejnë rreth 50% të votuesve nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019, janë deklaruar për zgjedhje. Përveç Lëvizjes VETËVENDOSJE!, edhe PDK kërkon zgjedhje pas pandemisë.² I vetmi kriter kushtetues, është votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë. Për dallim nga ky rast, Kushtetuta në shumë raste tjera parasheh që Presidenti ushtron kompetenca dhe autorizime në konsultim me institucione apo palë tjera, siç është caktimi i mandatarit për kryeministër pas konsultimit me partinë apo koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme, apo kur shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në konsultim me Kryeministrin, vendos për formimin e misionëve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin, si dhe emërimet e ndryshme, si Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Më tej, realizimi i këtij autorizimi nuk mund të jetë në diskrecion të vullnetit të Presidentit, marrë parasysh rolin dhe funksionin e Presidentit, por edhe ndikimin që do të kishte ushtrimi arbitrar i këtij autorizimi, si dhe mosrealizimi i një autorizimi të tillë për funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve, për sa kohë që Kushtetuta nuk ofron shprehimisht veprimin alternativ për Presidentin e Republikës. Në ushtrimin e kësaj kompetence, presidenti i republikës nuk gëzon diskrecion vendosjeje, meqë vendimi për të shpërndarë Kuvendin është i paralidhur me një kusht tjetër, siç është votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit, si dhe nga mospasja e alternativës të **përcaktuar me Kushtetutë për një veprim tjetër**.
6. Më tej, duke mos paraparë në Kushtetutë kurrfarë ndërlidhje në mes të votimit të suksesshëm të mosbesimit me nenin 95 të Kushtetutës, “Zgjedhja e Qeverisë”, kushtetutbërësi me vetëdije ka përcaktuar se efekti kushtetues i votimit të suksesshëm të mosbesimit është shpërndarja e Kuvendit. Një gjë e tillë, kuptohet qartë jo vetëm në perspektivë krahasuese të rregullimeve kushtetuese të vendeve të ndryshme në raport me Kushtetutën tonë, në të cilat shprehimisht përcaktohet jo vetëm mundësia, por në raste të caktuara edhe obligimi për të

² Deklarata e Kryetarit të PDK-së. <https://www.facebook.com/watch/?v=276799100014192>

provuar me zgjedhjen e një Qeverie të re brenda legjislaturës aktuale përkatëse, por edhe nga vetë struktura e Kushtetutës dhe funksioni i dispozitave kuptohet se veprimi i vetëm i Presidentit në rastin e Kosovës, është shpërndarja e Kuvendit. Nëse interpretimi i Presidentit do të ishte i drejtë se Kuvendi nuk shpërndahet pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, por vetëm pas dështimit për të zgjedhur Qeverinë dhe Presidentin, atëherë dispozita në nenin 82 paragraf 2 është krejtësisht e panevojshme dhe pa kurrfarë funksioni. Sepse, Kuvendi në rast të dështimit për të zgjedhur qeverinë apo presidentin në afatin e përcaktuar me Kushtetutë, shpërndahet automatikisht dhe vetvetiu sipas nenit 82, par. 1.1, dhe neni 82 paragraf 1.3 por edhe sipas nenit 95 paragraf 4. Madje edhe pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, po të ndërlihej votimi i mocionit me zgjedhjen e Qeverisë së re, Kuvendi do të shpërndahet pa u aktivizuar neni 82 paragraf 2. Mirëpo, në rregullimin kushtetues të Kosovës, neni 82 paragraf 2 ekziston pikërisht (ngase nuk ekziston alternativa) se nuk ekziston alternativë për të krijuar Qeveri të re pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, andaj si rrugëdalje kushtetuese është paraparë shpërndarja e Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve. Kësisoj, Presidenti i Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafi 2, mund ta shpërndajë Kuvendin në këtë rast, gjegjësisht, nëse me shumicën e duhur të deputetëve, votohet mocioni për mosbesim ndaj Qeverisë. Mundësia për të shpërndarë Kuvendin është në raport kushtëzues me përmbushjen e kriterit siç është votimi i mocionit të mosbesimit. Në atë rast, Presidenti thërret zgjedhjet për Kuvendin e ri, brenda 45 ditëve nga dita e shpërndarjes së tij. Siç argumentohet edhe në Komentarin e Kushtetutës së Kosovës, “Për të materializuar shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, presidenti i republikës është i paralizuar për katër kushte alternative: a) që Kuvendi të ketë kaluar një mocion mosbesimi ndaj qeverisë së Kosovës; b) që Kuvendi të ketë vendosur, sipas përcaktimit kushtetues, shpërndarjen e tij; c) që Kuvendi të ketë dështuar në zgjedhjen e presidentit të republikës, dhe që shpërndarja e Kuvendit të ketë ndodhur ipso iure; dhe c) që të ketë përfunduar mandati i rregullt kushtetues i Kuvendit, që nënkupton lindjen e detyrimit për shpalljen e zgjedhjeve të reja.”³

7. Është qartazi përcaktim i kushtetutbërësit, që përmes nenit 82 paragraf 2 të mundësohet qeverisje legjitime, duke synuar rikthimin e legjitimitetit për Kuvendin përmes zgjedhjeve. Për më tepër, edhe në aspektin historik, instituti i mocionit të mosbesimit si mjet kushtetues parlamentar, por jo i zakonshëm, ka pasur si efekt juridik primar shpërndarjen e Kuvendit edhe për shkak se marrëdhënia mes Presidentit dhe Qeverisë, si bartës të pushtetit ekzekutiv, është mjaft e afërt, sepse Presidenti i Republikës e cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën në Kuvend. Pikërisht për këtë, shtete të ndryshme përmes rregullimit kushtetues kanë kufizuar efektet kushtetuese të mocionit të mosbesimit për të shmangur shpërndarjen e Kuvendit, dhe këtë e kanë bërë zakonisht përmes dy modeleve të përgjithshme: së pari, një kryeministër apo qeveri mund të shkarkohet përmes votës së mosbesimit vetëm duke e zgjedhur një kryeministër apo qeveri tjetër në të njëjtën kohë. Së dyti, pas votimit të mosbesimit ekziston mundësia dhe afat i përcaktuar shprehimisht se Kuvendi mund të zgjedh një Qeveri të re. Kushtetuta e Kosovës nuk e parasheh as mundësinë e parë dhe as mundësinë e dytë, përveç veprimin për shpërndarjen e Kuvendit. Për më tepër, rendi ynë kushtetues i demanton këto dy opsione edhe me praktikën kushtetuese për raste dhe situata kushtetuese identike, si dhe me kapërcimin nga modeli që parashihte Korniza Kushtetues e Kosovës në rregullimin aktual. Shihet qartë që në Kornizën Kushtetuese procedura e mocionit të mosbesimit është e lidhur

³ Prof. Dr. Enver Hasani / Prof. Dr. Ivan Čukalovi, Komentari, fq. 395.

drejtpërdrejt me zgjedhjen e Kryeministrit pasues, si pjesë e së njëjtës procedurë. Korniza Kushtetuese jo vetëm nuk lejon vakum Kushtetues, por nuk parashikon përfshirjen e ndonjë organi tjetër kushtetues në procedurën që pason mocionin e suksesshëm. Kushtetuta në fakt ka këtë dispozitë të posaçme që i kushtohet pikërisht situatës së pas-mocionit të suksesshëm të mosbesimit. Ndryshe nga Korniza Kushtetuese, në Kushtetutë kjo situatë zgjidhet posaçërisht nga paragrafi 2 i nenit 82. Edhe nga pikëpamja e teknikës legislative, zgjedhja e parashikimit si paragraf më vete në nenin e posaçëm mbi shpërndarjen e Kuvendit legjitimon qëllimin e hartuesit të Kushtetutës për të parashikuar këtë si zgjidhje të situatës, madje zgjidhje të vetme të situatës. Për rrjedhojë, dallimi në mes të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kornizës Kushtetuese, qartazi vërteton se kushtetutëbërësi kapërcen nga modeli i mocionit konstruktiv, apo votimin e mocionit të mosbesimit të Qeverisë krahas dhe kushtimisht me përzgjedhjen e kryeministri tjetër, parashikuar nga Korniza Kushtetuese në përcaktimin e ndërprerjes së mandatit të Kuvendit së bashku, respektivisht pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë. Ky veprim i Presidentit jo vetëm është kundërkushtetues, por është në kundërshtim edhe me praktikën e deritanishme parlamentare në Republikën e Kosovës në rastet e ngjashme, në vitin 2010 dhe në vitin 2017, kur Qeveria e vendit shkarkohet me mocionin e mosbesimit. Si në vitin 2010 kur u.d. i Presidentit më 2 nëntor 2010 edhe më 10 maj 2017, Presidenti përmes Dekretit shpallin shpërndarjen e Kuvendit.⁴ Në dy raste të vetme të lartcekura kur në Kosovë është votuar suksesshëm mocion i mosbesimit ndaj Qeverisë, më 2010 dhe 2017, presidentët e atëhershëm kanë dekretuar shpërndarjen e Kuvendit brenda të njëjtës ditë kur është votuar mocioni dhe pa konsultim paraprak me partitë apo grupet parlamentare si dhe kanë dekretuar shpalljen e zgjedhjeve. Praktika e deritanishme e veprimit të Presidentit në rastet e shkarkimit të një qeverie me mocion mosbesimi nga Kuvendi, sikurse dëshmojnë rastet në vitin 2010 dhe në vitin 2017, për shpërndarjen e Kuvendit në rast të rrëzimit të qeverisë me mocion të mosbesimit, si në rastin e tanishëm të Qeverisë Kurti, nuk mund të ndryshohen në mënyrë arbitrare nga Presidenti nëse nuk ndryshojnë premisat themelore mbi të cilat është ndërtuar kjo praktikë, pra nëse nuk ndryshon Kushtetuta, konkretisht neni 82 par. 2.

Neni 95 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

8. Dekreti i Presidentit nr 24/2020 i datës 30 prill 2020, është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 95. Së pari, duhet evidentuar se Presidenti nuk e përcakton se në cilin paragraf të nenit 95 të Kushtetutës e bazon dekretin e tij për të caktuar z. Avdullah Hoti si kandidat për kryeministër. Siç dihet, neni 95 “Zgjedhja e Qeverisë” përmban gjashtë paragrafë të cilët rregullojnë situata të ndryshme. Neni 95, përcakton së paku tri situata të ndryshme nga njëra-tjetra të zgjedhjes së Qeverisë. Respektivisht, paragrafi 1 i nenit 95, përcakton procedurën dhe kriteret e propozimit pas zgjedhjeve të mandatarit nga Presidenti, në konsultim me partinë ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë, përkatësisht që ka fituar qoftë shumicën absolute, qoftë shumicën relative sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin K0103/14. Ndërsa, paragrafi 4 i nenit 95, përcakton autorizimin e Presidentit për të emëruar kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë, në rast se përbërja e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme sipas

⁴ Shih Dekreti i u.d. Presidenti, 02 nëntor 2010; Dekreti i Presidentit Nr.: DV-01-2017, datë 10.05.2017.

nenit 95 parq 2 dhe nenit 95 parq 3. Dhe së fundi, paragrafi 5 i nenit 95 përcakton se nëse Kryeministri jep dorëheqje ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partinë ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë. Duke mos precizuar se në cilin paragrafë të nenit 95 është bazuar, Presidenti manifeston se ka qenë i vetëdijshëm për antikushtetutshmërinë e dekretit, por është përpjekur ta pamundësojë identifikimin e mospërputhshmërisë së dekretit me Kushtetutën, duke mos përcaktuar bazën e qartë kushtetuese. Në mënyrë krejtësisht të kundërt kishte vepruar, kur kishte dekretuar z. Albin Kurti si kandidat për Kryeministër, ku ishte bazuar me saktësi, paragrafëve, 1 dhe 2 të nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në dekretin Nr 05-2020, të datës 20.01.2020. Në mungesë të referimit përkatës brenda nenit 95 të Kushtetutës nga ana e Presidentit, e bënë të nevojshme argumentimin e kundërkushtetutshmërisë së dekretit në raport me secilin nga paragrafët e këtij neni. Sidoqoftë, në mënyrën se si ka vepruar Presidenti, dekreti nr 24/2020 do të ishte në kundërshtim si me paragrafin 1 të nenit 95, paragrafin 2 të nenit 95, paragrafin 4 të nenit 95, si dhe paragrafin 5 të nenit 95.

9. Presidenti i Republikës së Kosovës, me aktivizimin kundërkushtetues të nenit 95, bën veprim kundërkushtetues edhe brenda kornizave të vetë nenit 95. Kësisoj, edhe nëse aktivizimi i nenit 95 do të kishte bazë kushtetuese në formë të shprehur, përmbajtja e dekretit sërish do të konsiderohet në kundërshtim me Kushtetutën. Së pari veprimi i Presidentit për të ftuar menjëherë pas votimit të mocionit të mosbesimit ndajë qeverisë në konsultime të gjitha partitë politike përbënë veprim antikushtetues, respektivisht në kundërshtim me nenit 84 par. 14 lidhur me nenin 95 par. 5 lidhur me par. 1 të këtij neni të Kushtetutës. Sepse në nenin 95 par. 1 dhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO103/14, konkretisht në pjesën e fundit të pikës 84, shprehimisht thuhet *“Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës mund të konsultohet vetëm me partinë politike ose me koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë relative.”* Në bazë të nenit 84.14 dhe nenit 95. 1 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk ka diskrecion për të caktuar apo refuzuar kandidatin për kryeministër, sikurse që nuk ka as diskrecion për vetiniciativë për të caktuar mandatarin. Në këtë fazë, Presidentit nuk i lejohet që të takojë apo konsultojë të gjitha partitë apo koalicionet, por duhet të konsultohet vetëm me partinë politike apo koalicionin që ka fituar shumicën, qoftë shumicën absolute, qoftë shumicën relative.
10. Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka autorizime kushtetuese për të caktuar në mënyrë arbitrare afate të cilat nuk i parasheh Kushtetuta se deri kur duhet të dërgojë propozimin partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme. Kushtetuta e Republikës së Kosovës kur bëhet fjalë për procedurën e zgjedhjes së Qeverisë, ka përcaktuar vetëm dy afate. Afatin jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, kandidati për Kryeministër paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvend dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit. Ndërsa, nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditëve emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Po ashtu, Presidenti nuk ka autorizime kushtetuese që të vlerësojë, konstatoj apo interpretoj arbitrarisht se meqenëse brenda një afati të paqenë në kuptimin kushtetues, partia politika nuk ka dorëzuar emrin e kandidatit për kryeministër, kësioj ka hequr dorë nga e drejta për të propozuar kandidatin për kryeministër. Duke qenë se Kushtetuta në asnjë dispozitë nuk e parasheh afatin prej njëzet (20) ditësh, të cilin e ka përdourr Presidenti, si dhe duke qenë se Kryeministri në detyrë, njëkohësisht Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! z. Albin Kurti në asnjë rast nuk ka refuzuar të dërgojë emrin e

kandidatit për Kryeministër, e aq më tepër, në asnjë rast nuk ka hequr dorë për propozimin e kandidatit për Kryeministër. Andaj, ekskluziviteti i dërgimit të emrit mbetet në diskrecionin e partisë fituese, e ky diskrecion është i paafatizuar. Kësisoj, edhe historia e krijimit të institucioneve kushtetuese në vitin 2014 dëshmon qartë se formimi i qeverisë ka zgjatur mbi 6 muaj, vetëm dhe kryekëput si pasojë e mosdërgimit të emrit të mandatarit te presidenti nga partia fituese. Në këtë kontekst, Presidenti i republikës së Kosovës nuk ka asnjë autorizim kushtetues për të vendosur afate që nuk parashihen me Kushtetutë apo për të konstatuar se një subjekt ka abdikuar nga një e drejtë, për sa kohë që nuk ka refuzuar shprehimisht e as nuk ka hequr dorë formalisht e shprehimisht nga propozimi i kandidatit për kryeministër. Nenit 95.1 dhe 95.5 ju mungon afati kohor, sikurse që mungon afati në mes të procedurës të nenit 95.1 dhe nenit 95.4. E njëjta pyetje ishte edhe në fillim – “pas zgjedhjeve” se sa duhet me pritë mandatarin nga partia që ka fituar zgjedhjet për të siguruar numrat Kuvend? Në të dy rastet ngritet çështje të njëjtë kushtetuese. Qartazi, këtu kemi përplasje në mes të palës që ka interesa të shprehura hapur dhe në kundërshtim me autorizimet e tij kushtetuese, siç është Presidenti, dhe një të drejtë të përcaktuar me Kushtetutë të partisë politike që ka fituar zgjedhjet. Siç e thotë, Komisioni i Venecias, edhe sikur Presidenti të kishte qëllim të mirë, ai nuk mund të tejkalojë autorizimet të përcaktuara me Kushtetutë, në rastin tonë, Presidenti qartazi ka shprehur në disa raste qëllime kundër partisë që ka fituar zgjedhjet e në kundërshtim me statusin e Presidentit si kreu i shtetit. Në rastin konkret, Presidenti nuk ka pasur qëllim që t’i jap mandatin partisë që ka fituar zgjedhjet, përkundrazi përmes të gjitha deklarimeve të tij publike, ai kishte shprehur vullnetin dhe kriteret jo kushtetuese se çfarë qeverie duhet të ketë vendi. Kjo, duke mos realizuar përgjegjësitë e Presidentit si pozitë neutrale, dhe interpretimi kushtetues e caktimi arbitrar i afateve.

11. Nisur nga këto, Presidenti, më 22.04.2020 në letrën Nr.380, jashtë autorizime të tij kushtetuese, konstaton se Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të propozuar kandidatin e ri për formim të Qeverisë, duke vepruar kështu jashtë kompetencave të tij kushtetuese, qoftë me interpretimin tekanjor të mos-propozimit të kandidatit si refuzim i marrjes së mandatit e po ashtu edhe me caktimin e afateve hipotetike e të paparapara me kushtetutë për propozim të kandidatit për mandatar. Me këtë, Presidenti ka marrë rolin e interpretuesit, e për më shumë, plotësuesit të Kushtetutës. Kushtetuta nuk parasheh afat për caktimin e kandidatit për mandatar nga partia fituese në zgjedhje, prandaj hamendësimi i një afati të tillë nga ana e Presidentit është i pa bazë. Letrën e Kryeministrit në të cilën edhe një herë thuhet në mënyrë eksplicite se nuk po refuzohet caktimi i kandidatit për mandatar, por po kërkohet sqarim dhe precizim i bazës ligjore mbi të cilën është bërë kërkesa, posaçërisht për sa i përket nenit 95, Presidenti e injoron duke iu drejtuar partisë së dytë për caktimin e emrit të kandidatit të tyre.
12. Neni 95 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nen të cilit i referohet presidenti në dekretin e kontestuar, përcakton procedurat e Zgjedhjes së Qeverisë dhe nuk përcakton situatat të cilat mund të interpretohen si refuzim i caktimit të kandidatit për mandatar e as nuk e përcakton afatin kohor për caktimin e të njëjtit. Ky nen jep afatin në rast të dështimit të votimit të Qeverisë për herë të parë, dhe jep edhe afatin e shpalljes së zgjedhjeve në rast të dështimit të dytë të votimit të Qeverisë, por nuk përmban asnjë fjalë për afatin e caktimit të kandidatit nga partia fituese. Për më tepër, Presidenti në dekretin e tij nuk tregon se cilit paragraf të nenit 95 është duke iu referuar. E, meqenëse nuk ka mundësi që për qëllimet e dekretit ti jetë referuar paragrafëve 1, 2, 3, 4 dhe 6, mund të konstatojmë se cilitdo nga tre paragrafët që fletë për

situata të ndryshme të zgjedhjes së Qeverisë, paragrafit 1, 4 dhe 5 të nenit 95, dekreti 24-2020 është në antikushtetues.